

E vërteta nuk mund të përballet

Nga Murat Basha

Ndjesë për një pasaktësi...

Në shkrimin tim të replikës së detyruar për shkrimin e firmëtarit Kastriot Myftaraj, ka patur një pasaktësi në lidhje me z.Gërmenji, të cilit gabimisht i faturova një vizitë në Johannesburg, në vitin 1994, gjë e cila nuk është e vërtetë, sepse z.Gërmenji asokohe nuk është lënë të udhëtojë (nga autoritetet shqiptare), së bashku me delegacionin, për në Afrikën e Jugut. Duke njohur gabimin, e vetmja gjë që mund të shpëtojë njeriu – është nderi dhe morali. Një filozof i madh anglez, Melone, thotë: “Duhet të kemi ecje korrekte, qoftë edhe përpara grushtit”. Po kështu, unë i përmbahem maksimës së famshme që thotë: “Nëse kanë vendosur të ta presin kokën, mbaje me dinjitet, mbi kërcu”.

Nuk është në moralin tim që të them të pavërteta, pra, njëkohësisht, edhe të mohoj të vërteta. Loja me të vërtetat dhe të pavërtetat është një tregues i karakterit, madje do të thoja se është sinjifikativ.

Nëse unë do ta ndërtoja jetën dhe karrierën time prej politikani mbi mashtrime, atëherë nuk do të isha ky që jam, pra Murat Basha i panjollë, që të gjithë e njohin për njeriun që nuk bën kompromise të ndyra me idealin dhe nuk pranon të përdhosë karakterin përkundrejt çdo çmimi apo afere.

T’i shërbesh të vërtetës është detyrim moral, sepse shpesh herë e vërteta është “viktimë” e padijes, indoktrinimit, dallkaukllëkut, maskarallëkut dhe perversitetit. Kjo ndodh sidomos pas një diktature të gjatë, “revolucionit” apo tranzicionit, pas çdo eksitimi të përbashkët shoqëror, ku egoizmi i një ose shumë individëve, apo edhe i shtresave të veçanta, natyrshëm mund të parashtrijë pretendimet e veta.

Identiteti politik dhe moral i Murat Bashës

Murat Basha vërtet është nënkryetar i PLL, anëtar i Këshillit bashkiak të Tiranës, dhe ka kthyer përgjigje jo për të bërë replikë, por për t’i shërbyer të vërtetës, kundër shpifësve dhe shtabeve që qëndrojnë pas tyre.

Unë nuk jam në Këshillin bashkiak të Tiranës për aferat e mia, por për t’i shërbyer tiranasve dhe legalistëve që më kanë zgjedhur, për t’i shërbyer qytetit ku familja ime jeton prej 101 vjetësh, qytetit që më ka lënë mbresat e kujtimet më të bukura dhe më të hidhura, ku kam thurur ëndrrat e mia, dashuritë e mia, dhimbjet e mia, ku kam varrosur miqtë e vdekur (të gjithë antikomunistë të thekur), pra për qytetin ndaj të cilit kam një dashuri të pamasë, e që më bëri të braktis Romën e Parisin, për t’u rikthyer sërish...

Unë dhe raportet me mediat

Nëse në shkrimet e ciklit të parë të shpifjeve, puna e shtabeve nuk dilte në pah, tani ajo është shpallur haptas dhe nënshkruesi është shndërruar në kronikan të tezave të shtabistëve. Firmëtarit mund të jetë autor i 3 librave dhe 200 shkrimeve, por varet se çfarë ka zhgarravitur në to, sepse tezat që ai ka hedhur në librat dhe në shkrimet e mëparshme, paturpësisht i kundërshton sot.

Ndërsa unë Murat Basha, kam bërë rreth 150 shkrime deri më sot, kryesisht në gazetën “Atdheu”, rreth 26 emisione televizive dhe debate e diskure të pafundme për tema të ndryshme, gjatë punës sime të përditshme si politikan.

Në gazetën “Shekulli”, në korrik 2000, (me rastin e emërimit të Bulevardit “Zog I” nga këshilli bashkiak i Tiranës), kam botuar një replikë me z.Xhelal Gjeçovi, ku me argumente,

bazuar mbi dokumente të nxjerrë nga Arkivi i Shtetit, hidhja poshtë trillimet e tij dhe të firmëtarit sot, për gjoja vrasjet e Avni Rustemit, Luigj Gurakuqit etj..

Ky shkrim asokohe nuk pati kundërpërgjigje as nga komunisti i thekur Gjeçovi, por përgjigjia i jepet sot, nga firmëtari “pseudodemokrato-djathtist”.

Meqenëse firmëtari përmend një “shkrim” timin tek “Shekulli”, (ku gjoja paskam bërë thirrje të votohet në favor të qeverisë), të paktën ta citonte këtë në ligjëratë të drejtë, sepse nëse do të ishte e vërtetë, nuk do të kishte argument më të fortë kundër meje. Megjithatë, le të pyesë z.Mero Baze dhe të lexojë gazetën e tij të datës 21.12.2001, kur në Hotel “Rogner” unë përdora të gjitha mënyrat, (përfshi edhe forcën), që të mos lejoja një deputet të PLL të shkonte në parlament për të ndihur socialistët të bënin kuorumin e nevojshëm, e më pas, të votonte për qeverinë e PS...

Lidhur me dëshirën e çmendur të firmëtarit për të bërë debat publik me mua, unë nuk kam asnjë kundërshtim, por do të dëshiroja të bëja debat me shefat e tij, sipas rangut.

Nëqoftëse firmëtari insiston, le t’u lutet shefave të shtabit që të na hapin dritare në studiot ku ata bëjnë ligjin, dhe unë do ta pranoj sfidën e të bëj debat me ta.

Për pretendimin se, gjoja, nuk i jam përgjigjur republikanit Begeja, e vërteta është ndryshe.

Për këtë, firmëtari do të bënte mirë të verifikonte kasetën origjinale në studiot e Tv “Arbëria”. Murat Basha nuk është pseudonim i Abdi Baletës. Pavarësisht nga respekti dhe vlerësimi maksimal që kam për z.Baleta, nuk do t’ia lejoja kurrë vetes që të nënshkruaja shkrime të bëra nga zotëria i nderuar, i cili aktualisht nuk është ideologu i LZHK.

Botuar tek tema 15.11.2004

Vazhdimi

Të vërtetat i mia kundër shpifjeve

Duke ia çjerrë në çdo rresht maskën firmëtarit dhe shpifësve pas tij, do t’u kujtoja se: 1.Gjyshi im vërtet quhej Murat Basha, dhe emrin e tij kam nderin ta mbaj. Ai ka lindur në vitin 1900 dhe nuk ka patur mundësi që të jetë oficer i ushtrisë turke, sikundër akuzon firmëtari.

Në maj të vitit 1903, babai i Muratit, nëna e tij dhe familja, erdhën në Tiranë, ku blenë një shtëpi në Rugën e “Kavajës”, pranë Xhamisë së Dine Hoxhës, shtëpi të cilën më vonë ia shitën kushëririt të tij Ibrahim Basha.

Murat Basha nuk ka ardhur nga Burgajeti, por nga Plani i Bardhë i Klosit, thënë ndryshe Kryematja. Familja e tyre në Plan të Bardhë ka qenë familje e kamur dhe me prona të shumta. Murat Basha, shkollën fillore e ka bërë në Mejtepen e Tiranës (Medreseja e sotme), ku ndër të tjerë ka patur profesor edhe patriotin e madh Hafiz Ibrahim Dalliu.

Më pas ka vazhduar shkollat ushtarake në vijimësi, deri në një specializim në Vjenë.

Në vitin 1922, gjatë kryengritjes së Elez Isufit, Murat Basha, si antiserb i tërbuar, ishte nga të paktët njerëz që qëndroi deri në fund dhe u plagos, gjë që e detyroi të çalonte e të identifikohet lehtësisht, çka në çdo moment bashkëkohësve u kujtonte meritat për të cilat shumë pak burra kishin të drejtë të krenoheshin...

Për këto arsye, Murat Basha nuk kishte nevojë të “shiste byrekë tek Ura e Tabakëve”, dhe pronën të cilën e nënkupton firmëtari, e ka blerë në vitin 1933 nga zotërinjtë e nderuar Ferit dhe Iljaz Toptani.

Unë nuk besoj se, asokohe, dera e madhe e Frashërllinjve do t’i jepte nuse një njeriu që “shiste byrekë tek Ura e Tabakëve”.

Përpos veprimtarisë së tij, të cilën do ta gjykojë koha dhe historia e paanshme, vlen të përmenden momentet e fundit dhe ekzekutimi i Murat Bashës, sipas anëtarit të Komitetit Qendror të “Balli Kombëtar” z.Xhemal Alimehmeti, i cili është akoma gjallë, e që ndër të

tjera deklarën: “Ishte data 7 qershor 1945, ora 9.00. Qysh në mëngjes, major Murat Bashën e të tjerë (plot 13 burra), i kishin lajmëruar se do të ekzekutoheshin. Unë rrija në një qoshe, i strukur, i mërziur dhe gjithë tension. Përbalë meje shihja Murat Bashën, që bisedonte me z.Xhemal Naipi (ish kryetari i parë i PLL), me z.Xhemal Kussin... dhe mendoja se ku e gjen forcën ky njeri dhe të tjerët që do të pushkatohen, që janë kaq të qetë!? Ata që pushkatoheshin, dukej sikur na jepnin zemër ne të tjerëve... Në orën 10.00, erdhën dhe i morën, i lidhën dy nga dy, i nxorën në korridor, pastaj i lidhën të gjithë me një litar të gjatë. Në këto momente dëgjohet zëri i major Murat Bashës: ‘Na i bëni hallall të gjitha or vëllezër, amanet gjakun..., Rroftë Shqipnia... Rroftë Mbreti...’.

Pastaj ne mbetëm të tromaksur kur major Murat Basha filloi të këndonte himnin e Flamurit, duke u pasuar nga të gjithë shokët e tij të lidhur..., dhe zërat e tyre u ndërprejnë vetëm nga krismat..., atje, në breg të Lumit...”.

Trupat e tjerë, të varrosur në Breg të Lumit, mbas disa vitesh i mori uji dhe kockat nuk u gjetën kurrë. Shpëtuan vetëm eshtrat e gjyshit tim, pasi im atë, Akil Basha, i mori fshehurazi, natën, dhe fillimisht i ka varrosur në ba a dn b

Individë, klane apo pseudoparti të djathta, (se e Majta po se po), janë munduar dhe mundohen të shkatërrojnë monumentet e historisë, bile bëjnë përpjekje donkishoteske për të ndalur apo ndryshuar rrjedhën e “lumis” të historisë.

E çfarë janë këta në fund të fundit, përveçse mbeturina të një epoke të errët, anakronizma të përçudnuar, viktima të trishtueshme të marshimit triumfator të historisë së vërtetë!

Duke sulmuar Mbretin Zog, Mbretin Leka, Princin Leka dhe zogistët, autorët godasin haptas tre njerëzit më të mençur që ka Partia Demokratike: Berishën, Ngjelën dhe Arbnorin. Ky i fundit, për vetë vlerësimin që i ka bërë periudhës së Mbretërisë, Mbretit Zog dhe Mbretit Leka, për shkak edhe të raporteve miqësore.

Ngjela, politikan që u zgjodh ministër dhe deputet i PLL me dëshirën personale të Mbretit Leka I-rë, kandidoi për t’u zgjedhur edhe kryetar i PLL.

Berisha, me fjalimet e mbajtura me rastin e pagëzimit të Bulevardit me emrin “Zog I”, në ceremoninë përkujtimore të 70 vjetorit të Monarkisë, apo edhe në parlamentin e vitit 2001 - deklaroi se “Mbretit Zog i kam borxh një përmendore në mes të Tiranës, për ato që bëri për Shqipërinë, kurse djalit të Tij, Mbretit Leka, i kam borxh një referendum për formën e regjimit”.

Sulmi kundër Mbretit Zog, si në 1994 edhe sot, pas 10 vjetësh, është një gafë e madhe politike dhe, në politikë, gafat janë më të rënda se krimet.

Kjo vjen nga harresa e mëkateve, sepse harresa e mëkateve lind paturpësinë.

Tashmë të gjithë e dinë se cilët janë mëkatarët dhe të paturpshmit.

Mbreti Leka anatemohehet paturpësisht, në një kohë që ka qenë i vetmi njeri që ka luftuar me të gjitha forcat dhe mënyrat për të përmbysur komunizmin dhe çliruar trojet etnike. Zakonisht, pasardhësit e njerëzve të mëdhenj humbasin në hijen e veprës së prindërve të tyre.

Mbreti Leka, jo vetëm që nuk ka humbur nën hijen e veprës së Mbretit Zog, por përkundrazi, ia ka shtuar asaj shkëlqimin me veprimet e veta. Natyrisht, shoqëria njerëzore ka enigmat e veta, enigma që, për njerëzit e mençur, zgjidhen e bëhen dritë, kurse për dallkaukët dhe perversët bëhen kurthe dhe pusi për intriga dhe prapaskena dhe shkaktojnë një turbullë të thellë. Problemet nuk kalojnë pa lëshuar në vetvete një hije, ashtu sikurse e shohim edhe vetë. Por sado e thellë dhe e madhe të jetë turbullëra, ajo nuk mund të fshehë për shumë kohë të vërtetën, sepse e vërteta qëndron si yjet, sipër reve dhe stuhive.

Ndërsa përsa i përket Princ Lekës, çuditëse se si guxohet të përbaltet një i ri 22 vjeçar, që në çdo ligjëratë të tij flet për Atdheun dhe Kombin, gjë që nuk e kemi dëgjuar sot nga asnjë bashkëmoshatar i Tij, përveçse nga gjyshi, Mbreti Zog. Por nuk çuditëse që artikullporositësit nuk e kuptojnë Princin Leka. Sepse edukimi nuk është i njejtë, si kur atë e kalitin majat e larta, ashtu edhe kur e pjellin fundërrinat.

Ndërsa sulmi ndaj LZHK, synon përfitime dhe efekte politike të drejtpërdrejta nga një takëm që votat e legalistëve, nacionalistëve, pronarëve dhe të Përndjekurve politike, për shumë kohë i kanë patur nëpër torba e i kanë shpërdoruar. Prej këtej rrjedh edhe shqetësimi dhe ngasja për të shpifur ndaj një lëvizjeje për zhvillim kombëtar, pra për të shpëtuar Shqipërinë dhe garantuar ardhmërinë...

Me shtabistët dhe firmëtarin, nuk pranoj të bëj polemikë në fushën e ideve, sepse ata janë të paaftë të polemizojnë e të replikojnë, aq më tepër kur arrijnë të shpifin e të shtrembërojnë edhe të vërteta historike që, në këtë vend, i dinë edhe fëmijët.